

VENDIM
Nr. 346, datë 15.5.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE, QARKU LEZHË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 15.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;

Denar Biba: zv.kryetar;

Bledar Skënderi: anëtar;

Edlira Jorgaqi: anëtare;

Rezarta Bitri: anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste, qarku Lezhë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Pjerin Zef Ndreu.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 1975/1 prot., datë 13.5.2018, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit të zonës zgjedhore, qarku Lezhë.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialiste e Shqipërisë për zonën zgjedhore qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 3 (tri) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste, qarku Lezhë, janë numri rendor 1 (një) z. Lindita Llesh Nikolla, numri rendor 2 (dy) z. Pjerin Zef Ndreu, numri rendor 3 (tre) z. Gjetan Kol Gjetani.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste, qarku Lezhë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumëmemërore me numër rendor 4 (katër), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Me shkresën nr. 3577 prot., datë 14.5.2019, znj. Adriana Hile Jaku, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Znj. Adriana Hile Jaku, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 15.5.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 6153.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të znj. Adriana Hile Jaku, rezulton se: Nuk ka deklaruar dënime penale, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 3596 prot., datë 15.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3595 prot., datë 15.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Lezhë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Adriana Hile Jaku, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1499/1 prot., datë 15.5.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Lezhë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Adriana Hile Jaku, sipas së cilës rezulton se është e padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Adriana Hile Jaku, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidate vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore, qarku Lezhë, i renditur me numër rendor 4 (katër), znj. Adriana Hile Jaku.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatin të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste, qarku Lezhë, znj. Adriana Hile Jaku.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri